

Analiza Financiare

Analiza financiare mund të behet për projekte investive tek të cilat janë caktuar madhësite fizike dhe çmimet për secilin veprim.

- ❖ Gjatë analizës merren çmimet konstante.
- ❖ Përcaktohet vëllimi i nevojshëm i mjeteve financiare,
- ❖ Obligimet eventuale ndaj burimeve të financimit
- ❖ Llogariten të ardhurat dhe shpenzimet e projektit investiv,
- ❖ Llogariten edhe rezultatet tjera

Planifikimi i vëllimit të investimeve

Planifikimi i tillë behët sipas:

- Struktues tekniko-teknologjike të projektit investiv
- Përfshin asetet fikse, asetet e xhiros(likuide) dhe investime tjera.

Investimet në asete fikse përfshijnë:

- Investimet për truallin, objektet ndërtimore, infrastrukturën
- Investimet në paisje
- Investimet themeluese dhe në pronësi industriale (projektet, patentat, licensat, know how)
- Vëllimi dhe dinamika e investimeve në asete fikse varet nga zgjidhja teknologjike dhe nga plani i termineve.

Investimi në asetet e xhiros

varet shumë nga natyra e projektit dhe llogaritja e aseteve të xhiros bëhet duke caktuar nevojat vjetore për:

- Lendën e parë dhe materialin riprodhues, ndihmës (lpm)
- Vlerën e prodhimit në vijim (pv)
- Vlerën e stoqeve të produkteve të gatshme (st)
- Obligimet ndaj furnitorve (of)
- Kerkesat nga blerësit (kbl)
- Qarkullimin në xhirollogari (xhll)
- Amortizimin (Am)
- Të ardhurat bruto personale (abp)
- Obligimet nga fitimi (ob)

Investimi në asetet e xhiros (laxh)varet shumë nga:

- Vëllimi dhe asortimenti i prodhimit
- Karakteristikat e prodhimit
- Kushtet e pagesës të furnitorve
- Karakteristikat e tregut të furnizimit
- Kushtet e pagesave të blerësve

Koeficienti i xhimit (kxh) te mjeteve:

$$kxh = 360 / di \text{ ,di-ditet imobilizuese}$$

(lidhmerise)

Investimi në asetet e xhiros (laxh)

$$laxh = \text{nevojat vjetore} / \text{koeficienti i xhiros}$$

Për lendet e para dhe materialin numri i ditëve të imobilizimit llogaritet nga kohëzgjatja e ciklit të prodhimit.

Per stoqet e produkteve të gatshme varet nga karakteri sezonal dhe kushtet e shitjes.

Mjetet në xhirollogari 10 ditë

Kerkesat dhe obligimet 15 ditë (ose sipas kontrates)

Mjetet për amortizimin 30 ditë

Mjetet për obligimet 30 ditë

Etj.

Ekzistojnë shumëllojshmëri metodash zhvlerësimi, por shumica ndahen në tre kategori të përgjithshme:

- 1. Zhvlerësimi në vije të drejta.**
- 2. Zhvlerësimi i pershpejtuar.**
- 3. Zhvlerësimin për njësi prodhimi**

Amortizimi -zhvlerësimi

Norma e amortizimit (am)

Llogaritet kur numrin 100 e pjestojmë me numrin e periodave të amortizimit ose me ciklin e eksploatimit të mjetit themelor. Psh. Nëse kemi një automjet i cili duhet të amortizohet brenda 5 viteve atëherë norma e amortizimit është: p.sh për 5 vite

$$am = 100/5 = 20\%.$$

Nëse na nevojitet të llogarisim **masën vjetore të amortizimit**, Psh nëse mjeti themelor me vlerë blerëse 25.000 € ka afat qëndrueshmerie 8 vite atëherë

- ✓ $Amv = V_{bath} \times am/100 = 3125 \text{ €}$; V_{bath} - vlera blerëse e mjetit themelor.

$$ku \quad am = 100/8 = 12.5\%$$

Viti	Vlera e Fillimit në Libër	Shpenzim Zhvlerësimi	Zhvlerësim i Grumbulluar	Vlera e Përfundimit në Libër
2004	\$50,000	\$12,000	\$12,000	\$38,000
2005	38,000	12,000	24,000	26,000
2006	26,000	12,000	36,000	14,000
2007	14,000	12,000	48,000	2,000

Afati i zhvlersimit në vijë të drejtë

- ❖ Metodatat e zhvlerësimit të përshpejtuar përdoren për dy arsye kryesore:
 - Një aset është më i vlefshëm në fillim të jetës së tij sesa më vonë.
 - Një arsye e dytë dhe më e zakonshme, për përdorimin e zhvlerësimit të përshpejtuar është për qëllime taksash.

Zhvlerësimi i shpejtuar

Viti	Shpenzime zhvlersimi	=	Vlera në libër	x	Norma e shpenzimit
2004	\$25.000		\$50.000		2/4
2005	12,500		25,000		2/4
2006	6,250		12,500		2/4
2007	4,250				

Amortizimi sipas njësis prodhuese (shërbyese) apo efektit të mjetit themelor.

Kjo metod përdoret më së shpeshti të mjetet transportuese.

P.sh. nese kemi një kamion me vlerë blerëse 60.000 € dhe eksploatim të paraparë deri në 300.000 km atëherë do të kishte amortizim :

$$60000 / 300000 = 0.2 \text{ për km}$$

Investimi në asetet e xhiros (laxh) shprehet:

$$\text{laxh} = (\text{lpm} + \text{pv} + \text{st} + \text{kb} + \text{xhl}) - (\text{of} + \text{Am} + \text{apb} + \text{ob})$$

ku :

- ✓ lpm- lenda e pare dhe materialet,
- ✓ pv- prodhimi vijues
- ✓ st- stoqet e gatshme
- ✓ kb- kërkesa nga bleresit
- ✓ xhl- qarkullimi ne xhirollogari
- ✓ of- obligimet ndaj furnitorve
- ✓ am – amortizimi
- ✓ apb-ardhurat personale bruto
- ✓ ob – obligimet nga fitimi

(vazhdim)

Në vëllimin e përgjithshëm të investimeve duhet të planifikohen edhe taksat të cilat ndërlidhen me marrjen e lejes (pëlqimit) për projektin.

Në fund të ciklit të eksploatimit të projektit paraqitet vlera e mbetur (rezidiale) e mjeteve themelore dhe mjeteve të xhiros për projekt.

Vlera e mjeteve të xhiros ruhet për veprime të metejme, ndërsa vlera e mjeteve themelore është vlera që e cakton tregun.

Çmimi mesatar i kapitalit të angazhuar në investime paraqet një vlerësim të kapitalit të angazhuar dhe shprehet :

$$\text{Çmk} = \sum(\text{shk} * I / \text{kpa}) , \text{ ku}$$

çmk – çmimi mesatar i kapitalit

shk - shuma e kredisë (apo letrave me vlerë)

I - interesi

kpa - kapitali i përgjithshëm i anagazhuar

Nje strukturë financimi e paraqitur në formë tabelare:

	€	Interesi (kamata)
<u>Kredi banklare</u>	700000	10.8%
<u>Letra me vlerë</u>	300000	10%
<u>Fondi aksionereve</u>	1100000	13%
<u>Gjithsejt</u>	2100000	

Sipas tabelës me sipër, mund të bëjmë këtë llogari:

$$\text{çmk} = \dots = 3.6 + 1.43 + 6.89 = 11.92 \%$$

Në kushtet e inflacionit duhet pasur kujdes me raportin në mes të interesit nominal dhe atij real .

Shembull: Llogaritja e interesit të thjeshtë :

- Shuma e kredisë (K) - 2000 €
- Kamata –interesi (i) - 9%
- Intervali (afati) i kthimit (n) - 3 vite
- Obligimi i përgjithshëm për klientin : $2000 \times 9\% = 2000 \times 0.09 = 180\text{€}$
- $3 \text{ vite} \times 180 = 540 \text{ €} \rightarrow 2000 + 540 = \underline{2540 \text{ €}}$
- Verejtje: Ketu llogaritja eshte bere me propozimin qe gjate gjith kohes borgji mbetet i pa ndryshueshem, dmth llogaritja e kamates nuk behet ne formen renese(zbritese) te shumes apo borgjit te mbetur.

Struktura e bilancit të suksesit

<u>Emërtimi</u>	<u>Vitet e eksploatimit</u>				
	0	1	2	...	n
I. <u>Të ardhurat e përgjithshme</u> - <u>Afarizmi (realizimi, shit.)</u> - <u>Financimi (kamatat)</u> - <u>Të ardhurat e jashtëzakon.</u>					
II. <u>Shpenzimet</u> - <u>Shpenzimet e afarizmit</u> <ol style="list-style-type: none"> 1. <u>Materiali dhe energjia</u> 2. <u>Amortizimi</u> 3. <u>Pagat bruto</u> 4. <u>Shpenzimet e tjera</u> - <u>Rivlersimi I jashtëzakonshëm</u>					
<u>Fitimi bruto (I-II)</u>					
<u>Tatimet dhe obligimet në fitim</u>					
<u>Fitimi neto</u>					

Shembull i një bilanci të suksesit në Britani të Madhe:

I.	Realizimi (shitja)	201,000
II.	Shpenzimet e prodhimit	168,100
-	Vlera blerëse e materialit e lëndëve të para	107,200
-	Pagat	51,200
-	Personeli administrativ	8,000
-	Amortizimi	3,800
-	Rritja e punës në vijim	(2,100)
III.	Profiti bruto ose margjina	32,900
IV.	Shpenzimet administrative	4,800
-	Vendosja e ptt	1,300
-	Sigurimi	1,200
-	Reklama	900
-	Kamat	1,400
V.	Profiti neto – para tatimit e taksave	28,100

Një raport i të ardhurave i detalizuar

- Bilancet e llogarive të te hyrave dhe të shpenzimeve paraqiten në raportin e të ardhurave të një Kompanie per muajin janar:

Data	Llogaritë	Asetet		=	Detyrimet		+	Ekuiteti i	
		Para të gatshme	Asete të tjera					Kapital i kontribuar	Fitime të mbetura
	Shumat Fillestare	11,400	+32,400	=	+30,000	+		10,000	+3,800
6 janar	Shpenzime furnizimesh Para të gatshme	-300							-300
8 janar	Shpenzime qiraje Para të gatshme	-600							-600
31 janar	Shpenzime pagash Para të gatshme	-1,000							-1,000
31 janar	Shpenzime tjera Para të gatshme	-200							-200
	Shumat mbyllëse	9,300	+32,400	=	+30,000	+		10,000	+1,700

Shembull: Raporti i të ardhurave për kompaninë Danfoss

Kompania Danfoss	
Raporti i të Ardhurave	
Për muajin që përfundoi më	
31 janar 2004	
Llogaritë	Balanca
Të hyra nga shitjet	\$11,400
Kosto e të mirave të shitura	(7,600)
Shpenzime pagash	(1,000)
Shpenzime qeraje	(600)
Shpenzime zhvleftësimi	(520)
Shpenzime furnizimi	(300)
Shpenzime komunale	(200)
Shpenzime interesi	(200)
E ardhura neto	\$ 980

Bilanci bazë për kompaninë Danfoss më 31 janar

Kompania e Biskotave Balancet e Llogarive 31 janar 2004

Llogaritë	Balanca
<i>Asetet:</i>	
Para	9,300
Inventari i mallrave	1,400
Paisje	31,000
Zhvleftësim i grumbulluar	(520)
Totali i Aseteve	41,180
<i>Detyrimet:</i>	
Interes i pagueshëm	200
Dëftesa të pagueshme	30,000
Totali i Detyrimeve	30,200
<i>Kapitali i Pronarëve</i>	
Kapital i kontribuar	10,000
Të hyra nga shitjet	11,400
Kosto e të mirave të shitura	(7,600)
Shpenzime pagash	(1,000)
Shpenzime qeraje	(600)
Shpenzime zhvleftësimi	(520)
Shpenzime furnizimi	(300)
Shpenzime komunale	(200)
Shpenzime interesi	(200)
Totali i Ekuitetit të pronarëve	10,980

Bilanci i kompanisë me 31 dhjetor 2004

Kompania e Biskotave Bilanci Më 31 dhjetor 2004

Asetet:

Asetet e tanishme:

Para	\$ 10,680
Llogari të arkëtueshme	8,570
Inventar i mallrave	23,600
Furnizimet	690
Qira e parapaguar	2,000
Totali i asetëve të tanishme	45,540
Prona dhe pajisjet në kosto	215,660
Zhvlerësimi i grumbulluar	(25,500)
Totali i asetëve	\$235,700

Detyrimet dhe ekuiteti i aksionerëve

Detyrimet e tanishme:

Llogari të pagueshme	\$ 9,610
Fitime të panxjerra	4,250
Interes i pagueshëm	650
Dëftesa të pagueshme, pjesa e tanishme	5,000
Totali i detyrimeve të tanishme	19,510
Dëftesa të pagueshme, afatgjata	73,200
Totali i detyrimeve	92,710

Ekuiteti i aksionerëve:

Aksione të zakonshme, emetuar 10,000 aksione	100,000
Fitime të mbajtura	42,990
Totali i ekuitetit të aksionerëve	142,990
Totali i detyrimeve dhe i ekuitetit të aksionerëve	\$235,700

Si informatë parësore tek krijimi bilancit të suksesit është edhe nxjerrja e çmimit të kostos së produktit (shërbimit). Çmimi i kostos llogaritet apo nxjerret nga këta parametra:

$$\text{Çk} = \text{shm} + \text{am} + \text{apb} + \text{shtj} + \text{tt}$$

ku :

shm - shpenzimet materiale

am - amortizimi

apb - të ardhurat personale bruto

shtj - shpenzime tjera të afarizmit

tt - obligimet për tatime dhe taksa.

Pasqyra e rrjedhave të parasë
shpjegon ndryshimet në keshin e
kompanisë gjatë periudhës
fiskale.



Informatë për analizen finnaciare është
edhe Rrjedhat e Keshit (Cash flows).

Struktura e Rrjedhës së Parasë (Cash Flows)

	<u>Vitet e punës</u>				
	0	1	2	...	n
A. TË ARDHURAT E PROJ. INVESTIV					
I. <u>Të ardhurat e përgjithsme</u>					
- shitja + subvencionet					
- të ardhurat tjera					
II. <u>Burimet e financimit</u>					
III. <u>Kthimet nga plasmani</u>					
IV. <u>Vlera reziduale</u>					
B. SHPENZIMET E PROJEKTIT INVESTIV					
I. <u>Investimet</u>					
II. <u>Zëvendësimi i pajimeve</u>					
III. <u>Shpenzimet e afarizmit (pa amortizim)</u>					
IV. <u>Të ardhurat personale bruto</u>					
V. <u>Obligimet tatimore e taksat</u>					
VI. <u>Obligimet ndaj financuesve</u>					
C. VLERA NETO (A-B)					

Formati direkt(I drejteperdrejtë)

Formati direkt I përgjigjet pyetjes,
“Nga ka ardhur keshi dhe ku ka
shkuar keshi?”



**Shembull: Raporti I rrjedhjes së parave-
-formati I dreitpërdrejtë.**

**Kompania e Biskotave
Raporti i Rrjedhjes së Parave
Për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2004**

Aktivitetet operuese	
Marje: Mbledhje nga klientët	\$682,080
Pagasa	
Për inventar	(471,590)
Punonjësve	(70,800)
Për qiranë	(24,000)
Për shpenzime të shërbimeve komunale	(4,500)
Për furnizime	(15,990)
Për sigurime	(3,700)
Për reklama	(6,500)
Për interes	(4,150)
Për taksa mbi të ardhurat	(22,710)
Rrjedhja neto e parave nga aktivitetet operuese	58,140
Aktivitetet investuese	
Pagasa për blerjen e pajisjeve	(216,000)
Hyrje nga shitja e pajisjeve	340
Rrjedhja neto e aktiviteve investuese	(215,660)
Aktivite financuese	
Hyrja nga shitja e aksioneve të zakonshme	100,000
Pagasa e dividendëve	(10,000)
Hyrja nga huatë	80,000
Ripagime të borxhit	(1,800)
Rrjedhja neto e parave nga aktivitetet financuese	168,200
Rritja neto e parave	10,680
Balanci i parave, 31 dhjetor 2003	0
Balanci i parave, 31 dhjetor 2004	<u>\$ 10,680</u>

Formati jo i drejtperdrejte(indirekt)
Formati jo i drejtperdrejte(indirekt)

Formati indirekt i përgjigjet
pyetjes: “Perse rrjedhja e
parave nga veprimet
ndryshon nga e ardhura
neto?”



Shembull: Formati jo i drejtpërdrejtë i raportit të rrjedhjes së Parave.

Kompania e Biskotave
Raporti i Rrjedhjes së Parave
Për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2004

Veprimet operuese	
E ardhura neto	\$ 52,990
Shpenzime zhvlerësimi	25,500
Rritje në llogaritë e arkëtueshme	(8,570)
Rritje në inventarin e mallrave	(23,600)
Rritje në furnizime	(690)
Rritje në qiranë e parapaguar	(2,000)
Rritje në llogaritë e pagueshme	9,610
Rritje në të hyrat e pafituara	4,250
Rritje në interesin e pagueshëm.	650
Rrjedhja neto e parave nga veprimet operuese	58,140
Veprimet investuese	
Pagesat për blerjen e pajisjeve	(216,000)
Marrë nga shitja e pajisjeve	340
Rrjedhja neto e parave nga veprimet investuese	(215,660)
Veprimet financuese	
Marrë nga shitja e aksionit të zakonshëm	80,000
Pagesa për dividendët	(1,800)
Marrë nga huaja	100,000
Pagesa e borxhit	(10,000)
Rrjedhjet neto të parave nga veprimet financuese	168,200
Rritja neto e parave	10,680
Bilanci i parave më 31 dhjetor 2003	0
Bilanci i parave më 31 dhjetor 2004	\$ 10,680

(vazhdim)

Në bazë të rrjedhës së parasë apo rrjedhes financiare mund të bëhet vlerësimi i likuiditetit të projektit.

Likuiditeti është kusht për aftësin që projekti çdoherë të ju përgjigjet obligimeve financiare.

Vlera neto në rrjedhen e parasë tregon për aftësin që projekti të jetë i aftë apo jo të ju përgjigjet obligimeve, si në periudhen e investimeve poashtu në fazën e eksploatimit.

- Nëse Vlera Neto > 0 projekti është i aftë të “mbijetoi”
- Nëse Vlera Neto < 0 projekti vështirë “mbijeton”